



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 2692/3 prot.

Tiranë, më 23 4.2020

NJOFTIM

Z. ARBEN MOLLA

Në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Pjesa e VII, Neni 162 dhe pasi shkresa me Nr. 2692/1, datë 10.4.2020 dhe shkresa me Nr. 2692/2, datë 10.4.2020, “Njoftim mbi detyrimin për tu paraqitur në punë”, dërguar në adresën “Bulevardi Zogi I”, pallati Edicom, shkalla 1, ap. 11 B, z. Molla nuk u përgjigj, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural vendosi njoftimin publik të z. Molla si më poshtë vijon:

Në mbështetje të nenit 66/1, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, të ministrit të Shtetit për Inovacionin e Administratës Shtetërore, të Vendimit nr. 144, datë 3.3.2006, të Komisionit të Shërbimit Civil, si dhe shkresës Nr. 1489/2, datë 6.4.2020, “Përcillet akti i emërimit për z. Arben Molla”, të Departamentit të Administratës Publike, jeni emëruar nëpunës civil në pozicionin e drejtorit në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kategoria e pagës II-b.

Marrëdhëniet financiare në këtë pozicion kanë filluar më datë 14.4.2020, në zbatim të afateve ligjore dhe të shkresës Nr. 1489/2, datë 6.4.2020, “Përcillet akti i emërimit për z. Arben Molla”, të Departamentit të Administratës Publike.

Bëjmë me dije se ju mbartni detyrimin të paraqiteni në punë në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përsa kohë marrëdhëniet tuaja të punës janë lidhur.

Sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Pjesa e VII, Neni 162, pika 3, bëjmë me dije se ky njoftim, përveç se në këndin e njoftimit në MBZHR dhe në faqen zyrtare elektronike “bujqesia.gov.al”, gjendet edhe në këndin e njoftimit në Njësinë Bashkiake nr. 9, ku rezulton i regjistruar z. Molla dhe në faqen zyrtare elektronike të kësaj njësie bashkiake tirana.al/njesia-administrative/njesia-nr-9.

Njoftimi shpallet sot më datë 27.4.2020 dhe hiqet më datë 7.5.2020.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Enea Hoti

